

E nderuar Znj. [REDACTED]

Ne lidhje me kerkesen per informacion te z.T [REDACTED] H [REDACTED], drejtuar Drejtorise se Pergjithshme te Doganave (z.Genti Gazheli- Drejtor i Pergjithshem), nepermjet emailit te datës 30/03/2023 ([REDACTED]@[REDACTED].al) ju bejme me dije se:

A)

Neni 20

Komunikimi i informacioneve dhe mbrojtja e të dhënave  
ligji 102/2014 Kodi Doganor

Çdo informacion i marrë nga autoritetet doganore gjatë kryerjes së detyrave të tyre, i cili është i një natyre konfidenciale ose që është marrë në mënyrë konfidenciale, mbulohet nga kushti i sekretit profesional. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, të nenit 48, ky informacion nuk jepet nga autoritetet kompetente doganore, **pa lejen e shprehur të personit ose autoritetit që e ka dhënë atë.**

Per shkak te zbatimit te legjislacionit specifik, ne lidhje me kerkesen e z. H [REDACTED], nuk ekziston nje dokument i subjektit te permendur (z.K [REDACTED]), ne forme shkresore, ne lidhje me aprovimin per venien ne dispozicion te dokumentave te kerkuara per zyrën avokatore. Gjithashtu, nuk ekziston ne kete faze, as edhe nje detyrim gjyqesor, per venien ne dispozicion te dokumentave te pretenduara.

B)

Ne lidhje me dokumentin, e pretenduar kontrate blerje (sipas e-mailit te dates 30 Mars 2023, [REDACTED]@[REDACTED].al), mungojne elementet thelbesore, të cilat e bejne te vlefshem dhe juridikisht te pranueshem vullnetin e paleve te permendura aty (nenshkrimi/et, vula/t, noterizimi, etj).

C)

Ne lidhje me dyshimin e z.H [REDACTED] se doganat shqiptare transferojne pronesine e mjetit, si dhe kerkohen arsyet, ju bejme me dije se bazuar ne legjislacionin kombetar (shqiptar) administrata doganore eshte pergjegjese per mbikëqyrjen dhe kontrollin e të gjitha mallrave që hyjnë/dalin nga territori doganor mbi bazën e formaliteteve doganore dhe në përputhje me mënyrat e përcaktuara. Si e tille, certifikata e origjines se mallit, pronesia e mallit, etj, jane dokumente te cilat nuk mund ti leshoje dogana shqiptare, por jane ne ngarkim te vendit të origjines (tranzitit, etj).

Ne zbatim te legjislacionit aktual (per mallin qe ju pretendoni), rregullat mbi të drejtat dhe detyrimet e subjekteve - shqiptare/të huaja me qendër/ose jo në Shqipëri, vendosen dhe mbikqyren nga organi/net kompetente shqiptare në fushën e detarisë, si e tillë, është jashtë sferës së veprimtarisë së administratës doganore.

Ç)

Sipas Kodit Doganor 102/2014 (i ndryshuar) dhe ligjit për akcizat 61/2012 (i ndryshuar), administrata doganore eshte pergjegjese vetem per mbledhjen e **Detyrimeve doganore**, te cilat jane një lloj i veçantë i taksave indirekte (ose te terthorta) të cilat paguhen me rastin dhe në kohën e kalimit të mallrave nëpër kufirin doganor.

D)

Se fundmi, mund te sugjerojme se dokumentat qe kerkuesi pretendon (nje kopje), mund ti marre nga vendi prodhues/transportues, si origjinues të mallit, pasi bazuar ne rregullat e pergjithshme te harmonizuara europiane jane te detyruar te veproje ne perputhje me rregullat për daljen e mallit nga vendi i origjines/prodhues/transportues.